

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin për të mitur e përbërë nga gjyqtarët–Valdete Daka, kryetare, Nesrin Lushta e Avdi Dinaj-anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të miturit F. K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale dhunimi nga neni 193.par.2.pika 1.të KPK, duke vendosur sipas kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit dhe të mbrojtësit të miturit të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren PM.nr.5/2013 të datës 08.06.2016. dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAM.nr.50/2016 të datës 07.09.2016., në seancën e mbajtur më 14.12.2016., mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit dhe të mbrojtësit të të miturit F. K. anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAM.nr.50/2016 i datës 07.09.2016. dhe lënda i kthehet asaj gjykate në rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren PM.nr.5/2013 të datës 08.06.2016. i mituri F. K. është shpallur “përgjegjës” për veprën penale dhunimi nga neni 193.par.2.pika 1.të KPK dhe është gjykuar me dënim me kusht me të cilin i është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh i cili nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 3 (tre) vitesh nuk kryen vepër tjetër penale. Është obliguar

të paguaj shpenzimet e procedurës penale ndërsa për realizimin e kërkesës pronësoro juridike e dëmtuara është udhëzuar në kontestin civil.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit të Kosovës ka marrë aktgjykimin PAM.nr.50/2016 të datës 07.09.2016. me të cilin janë refuzuar si të pa bazuara ankesat e paraqitura ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjytimeve kërkesë për mbrojtën e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të miturit, avokati A. K. nga Prizreni për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që të anulohen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, ndërsa kundër aktgjykimit të shkallës së dytë kërkesë ka paraqitur Prokurori i Shtetit, me parashtrësën KMLP.I.nr.14/16 të datës 07.10.2016., po ashtu për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, pa ndonjë propozim, përveç që kërkesa të aprovohet si e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK lidhur me nenin 5.të KDM, vlerësoi pretendimet në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

-kërkesat janë të bazuara.

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit pretendohet se aktgjykimi i shkallës së dytë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse në kolegjin e shkallës së dytë ka marrë pjesë gjyqtari Hashim Çollaku i cili duhej të përjashtohej me që ka marrë pjesë në të njëjtën çështje si prokuror dhe e ka paraqitur dhe ka përfaqësuar propozimin për shqiptimin e masës edukuese para gjykatës. Në këtë mënyrë pretendohet se është bërë shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale nga neni 384.par.1.pika 2.të KPPK.

Mbrojtësi i të miturit pretendon se aktgjykimet bazohen në provë të papranueshme, që është mbrojtja e të miturit e dhënë në polici, sepse nga procesverbali i cili gjendet në shkresat e lëndës rezulton se policia e ka marrë në pyetje të miturin pa

prezencën e mbrojtësit dhe pa e informuar për të drejtën e angazhimit të mbrojtësit, e në këtë mënyrë është bërë shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale nga neni 384.par.1.pika 8., por edhe nga par.2.pika 2.i këtij neni sepse konform dispozitave të KDM, i mituri duhet të ketë mbrojtës që nga fillimi i procedurës penale. Ka përkrahur kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit.

Gjykata Supreme gjeti se është i bazuar pretendimi për ekzistimin e shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384.par.1.pika 2. të KPPK sepse nga shkresat e lëndës me pa mëdyshje vërtetohet se Hashim Çollaku i cili në atë kohë ka qenë prokuror në Prokurorinë e Qarkut në Prizren ka paraqitur propozimin për aplikimin e masës edukuese PPM.nr.27/2008 të datës 19.01.2009. të cilin e ka përfaqësuar në shqyrtimin gjyqësor e më vonë ka marrë pjesë në vendosjen për ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit të shkallës së parë të marrë në çështjen e njëjtë penale, si kryetari kolegjit në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Konform dispozitës se nenit 39.par.1.pika 4.të KPPK bazë për përjashtimin e gjyqtarit nga ushtrimi i funksionit gjyqësor është rasti kur në çështjen e njëjtë penale ka marrë pjesë në procedurë si prokuror dhe në këtë mënyrë aktgjykim i shkallës së dytë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 385.par.1.pika 2.të KPPK, me që në shqyrtimin (seancën) e shkallës së dytë ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet.

Nga kjo arsye ishte i bazuar pretendimi në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit, i cili u mbështet edhe nga mbrojtësi i të miturit dhe u vendos që aktgjykimi i shkallës së dytë të anulohet dhe çështja të kthehet Gjykatës së Apelit të Kosovës në rivendosje. Në shqyrtimi ne serishëm duhet të eliminohet shkelja e përshkruar e dispozitave të procedurës penale ashtu që gjyqtari Hashim Çollaku të mos të jetë kryetar ose anëtar i këtij kolegji dhe të merret vendim i ligjshëm.

Për shkak të këtij vendimi, pra, se çështja-ankesat e paraqitura edhe një herë do të shqyrtohen në gjykatën e shkallës së dytë, pretendimet tjera në kërkesën për mbrojtje të

ligjshmërisë të mbrojtësit të miturit nuk u shqyrtuan por duhet të merren në konsideratë në procedurën e serishme.

Nga këto arsye konform nenit 438. par.1.2. të KPPK lidhur me nenin 5.të KDM, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pml.nr. 290/2016, më 14.12.2016.

Proçesmbajtësja,
Minire Xhambazi

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka